

INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2024, DERI MË 30.01.2025

TË DHËNA JAVORE

Në periudhën 24.01-30.01.2025 është regjistruar një rast i ri me pertusis. Bëhet fjalë për një fëmijë nga Probishtipi në moshë 3 vjet, i vaksinuar sipas moshës, e që ka lidhshmëri epidemiologjike me një të sëmurë tjetër nga po e njëjta familje.

Të dhëna kumulative

- Në vitin 2024 deri më 30.01.2025 janë regjistruar gjithsej 1.179 raste me pertusis me incidencë 64,2/100.000 banorë.
- Numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup (70,4%) ndërkohë që raste janë regjistruar edhe në 22 qytete të tjera.
- Në RMV ka epidemi aktive në Shkup.
- Numri më i madh i të sëmurëve i përkasin grupmoshës 0-4 vjet (37%), ndërsa incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet (1.566,4/100.000).
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve (1.179), 746 ose 63,3% nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk i kanë marë të gjitha dozat e vaksinës, ose nuk ka të dhëna për vaksinim.
- Nga rastet që janë plotësisht të vaksinuar, nga pranimi i dozës së fundit ka kaluar mesatarisht 13,7 vjet.
- Në spital janë shtruar 191 persona, ndërsa numri më i madh i tyre (n=167, 87,9%) janë nga 0- 4 vjet, e që kanë qëndruar në spital mesatarisht nga 8 ditë.
- 1.176 raste janë konfirmuar në laborator.
- Nga 18.01.2024 - 30.01.2025 janë dhënë gjithsej 96.114 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër pertusis.

**Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive
ISHPRMV**

31.01.2025